



AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER
Njësia e Prokurimit

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **"Rikonstruksion i shkolles se mesme Janaq Kilica, Fier"**
Nr. i Referencës së Kontratës se Sipërmartjes : **7/122-231/2015**

Kjo Kontratë është lidhur më **08/ 07/ 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë)**, midis Bashkise Fier, Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese" tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe Bashkimit të Operatoreve "**Kola Invest sh.p.k. Fier & Kupa sh.p.k. Durres**" me NIPT K93103401G dhe NIPT K51615512C, të perfaqësuar në këto kontrate nga Perfaqësuesit ligjor përkatësisht me z.Jani KOLA për shoqerine "Kola Invest" sh.p.k. Fier dhe z.Shkelqim KUPA për shoqerine "Kupa" sh.p.k. Durres, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për kryerjen e punimeve, duke i'u referuar Prokurimit **Nr.REF- Nr.6 – 11-05-2015**.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **10.06.2015** bie dakord të kryejë punimet, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formulari i Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **pa t.v.sh. 22 637 595 lekë (njezet e dy milion e gjashte qind e tri dhjete e shtate mije e pese qind e nente dhjete e pese)** dhe me t.v.sh. **27 165 114 leke (njezet e shtate milion e nje qind e gjashte dhjete e pese mije e nje qind e katermbedhjetë)**, për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë :



1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: 10 % te vleres se kontrates dhe në formën e: garanci bankare ose siguracion prane shoqerive te licensuara, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 08/ 07/ 2015 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Për dhe në emër të :

**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER**

Baftjar ZEQAJ
KRYETAR I BASHKISË




Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

**Bashkimi i perkohshem i shoqerive
"KOLA INVEST" shpk Fier &
"KUPA" shpk Fier**

Jani KOLA
PËRFAQËSUES LIGJOR (KOLA INVEST)

Shkelqim KUPA
PËRFAQËSUES LIGJOR (KUPA sh.p.k.)





**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER**

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636; www.bashkiafier.gov.al

Nr. _____ Prot.

Datë 08/07/ 2015

KONTRATE SIPERMARRJE NR. 7 /122-231/2015 ME OBJEKT :

"Rikonstrukcion i shkolles se mesme Janaq Katica, Fier"

Drejtuar : _____

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA FIER
- ❖ KONTRAKTOR : Bashkimi i perkohshem i shoqërive "Kola INVEST"sh.p.k. Fier & "KUPA"sh.p.k. Durres



KONTRATE SIPERMARRJE Nr.7 /122-231/2015

“Rikonstruksion i shkolles se mesme Janaq Kilica, Fier”

Lidhur sot, më date 08/07/2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë) midis Bashkise Fier, perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise z.Baftjar ZEQAJ nga njera ane dhe bashkimit te perkohshem te shoqerive “Kola Invest sh.p.k. Fier + Kupa sh.p.k. Durres”, me K93103401G dhe K51615512C, te perfaqesuar ne kete kontrate nga Perfaqesuesit ligjor perkatesisht me z.Jani Kola per shoqerine “Kola Inest” sh.p.k. Fier dhe z.Shkelqim Kupa per shoqerine “Kupa” sh.p.k. Durres, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PERKUFIZIME:

1. “Kontrate” do te thote Kontrate Sipermarrje nr. 7 /122-231/2015, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. “Vlefte e Kontrates” eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates 10.06.2015 te organizuar ne Bashkine Fier per ndertimin e ketij Objekti.
3. “Objekt” do te thote “Rikonstruksion i shkolles se mesme Janaq Kilica, Fier”, Fier, Shqiperi, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
4. “Autoriteti Kontraktor” eshte BASHKIA FIER.
5. “Kontraktor” eshte bashkimi i perkohshem i shoqerive “Kola Inest”sh.p.k. Fier & “Kupa” sh.p.k. Durres, themeluar sipas Kontrates per bashkimin e perkohshem, perpara noteres Ilda Sharra me nr.742 Rep. e nr.476 Kol.date 09.06.2015 me pjese takuese 93% per “Kola Inest” sh.p.k. dhe 7% per “Kupa” sh.p.k.. Perfaqesuesi ligjor i “Kola Invest” sh.p.k. Fier z. Jani Kola perfaqeson ne kete kontrate bashkimin e perkohshem te shoqerive ne perputhje me vullnetin e shprehur nga palet ne Prokuren e Posacme me Nr.743 Rep. dhe Nr.477 Kol., dt.09.06.2015 te lidhur perpara noteres Ilda Sharra. “Kola Invest” sh.p.k. Fier gezon personalitet juridik e ligjor pasi rezulton i regjistruar sipas ekstraktit te QKR me NIPT K93103401G dhe License Zbatimi te Punimeve NZ 6162/5 date 19.02.2015.
6. “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. “Situacion Pjesor” do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. “Situacion Perfundimtar” do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuara ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. “Data e kryerjes se plote” do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. “Kryerja” do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. “Difekt” do te thote cdo pjese e ndertimeve e parealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. “Data e hyrjes” do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.
13. “Materiale” do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trupezimin e tyre ne ndertimin e objektit.
14. “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit



- 2






5. "Mbikqyresi i punimeve" (Supervizori) do te thote subjekt fizik/juridik i lecsuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje per ndertimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjsite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 "Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit" te ndryshuar, U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe paraqiten ne Kontraten e Mbikqyrjes.
16. "Kolaudatori" do te thote subjekt fizik/juridik i lecsuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate per Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjsite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 "Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit" te ndryshuar dhe paraqiten ne Kontraten e Kolaudimit.
17. "Ndertime" do te thote Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjese perberese e Kontrates.
18. "Llogaritja e afateve" Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.
19. "Afati i Garancise se Punimeve" do te thote periudha prej **24 muaj** e cila fillon nga data e aktit te kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasoje e cilesise se punimeve te kryer prej tij.
20. "Garancia e Punimeve", eshte vlere prej **5%** e vlefes se sitacionit perfundimtar te miratuar.
21. "Baza ligjore" Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfshire te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Kontraktorit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.
22. "Force Madhore" do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfshihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri permytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

I. OBJEKTI I KONTRATES

"Rikonstrukcion i shkolles se mesme Janaq Kilica, Fier", sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte **me TVSH 27 165 114 leke** (njetzet e shtate milion e nje qind e gjashte dhjete e pese mije e nje qind e katermbedhjete), dhe afati i kryerjes se punimeve eshte **3 (tre) muaj**.

Ne vendimin e Komitetit te Zhvillimit te Rajoneve nr.11, dt.25.02.2015 "Per shperndarjen e fondit per infrastrukturen vendore dhe rajonale, pjese e Fondit per Zhvillimin e Rajoneve per vitin 2014" dhe te shkreses se Ministrise se Financave nr. 3997 prot, dt.16.03.2015 "Mbi detajimin e fondeve per zhvillimin e rajoneve", kontraktohet me vlere te plote, por **per vitin 2015 do te financohet ne vleren 23 425 851 (njetzet e tre milion e katerqind e njetzet e pese mije e tete qind e pese dhjete e nje) leke me TVSH, pjesa tjeter do te financohet ne vijim, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**

Kontraktori eshte i detyruar te perfundoje te gjitha punimet (volumet e parashikuara ne preventiv) sipas afateve te zbatimit te punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve perkatese pavarsisht financimit.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republikën e Shqiperise.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK

1. Te njohe zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoj atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Fier do te vendosen si



- 3 -



perfaqesues prane sipermarresit, persona te autorizuar prej Kryetarit te cilet do te jene me cilesite e meposthme :

– Mbikqyresi i punimeve : _____

2. Te marre te gjitha masat pergatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoj Kontraktorin te hyj ne Objekt dhe ta dorezoj ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
3. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.
4. Brenda Dates se Hyrjes te siguroj te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoj kushte pune normale Kontraktorit.
5. Te miratoj Situacionin Pjesor dhe Sitacionin Perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
6. Te asistoj ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektivit.
7. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektivit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.02.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit origjinal te kontrates.
8. Autoriteti Kontraktor ne çdo kohe, mund te porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:
 - a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
 - b) Korrigjime në materiale
 - c) Korrigjime në sasi
9. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
10. Te marre ne dorezim Objektivin pas kolaudimit perfundimtar.
11. Te vëri ne shfrytëzim Objektivin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje Certifikaten e garancise se punimeve.
12. Verifikon kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlefte e Garancise se Punimeve.
13. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korrupsionit ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

IV. TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)


1. Te siguroj Kontraten ne vleren 10% te vlefes totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 18 te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



- Secila anetare e ketij bashkimi te perkohshem shoqerish merr persiper te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet perpara Bashkise Fier si veç e veç ashtu edhe bashkarisht (detyrim solidar), si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjiesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrje, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
- Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
 - Ne qofte se Kontraktori braktis Objektivin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Fier dhe Garancine e Kontrates.
 - Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj.
 - Palet nuk çlirohen nga cdo pergjegjiesi per mos zbatimin e termave te kesaj e Kontrate, pervec se ne rast te veprimit te forcave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
 - Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Specialistin e Investimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve Publike te Bashkise Fier, pasi ky i fundit do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithe procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.
 - Per cdo dite vonese tej afatit te punimeve, Kontraktori eshte i detyruar t'i paguaj Investitorit, **gjobe ne masen 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
 - Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
 - Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerine qe perfaqeson bashkimin e perkohshem ne Banken Procredit, ne nr.klienti 10085204 dhe nr. llogarie 108520450001 te subjektit "Kola Invest" dhe ne BKT Tirane me nr.llogarie 411249542 e subjektit "Kupa sh.p.k."
 - Çdo mosmarveshje qe do te linde gjate zbatimit te kesaj Kontrate, palet do ti zgjidhin me mirekuptim, ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Fier.
 - Pjese perberse e kesaj Kontrate jane edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime qe eshte paraqitur ne tender nga Sipermarresi si dhe Specifikimet Teknike te punimeve te pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
 - Çertifikata e Garancise se Punimeve leshohet pas perfunimit te Afatit te Garancise qe eshte **24 muaj**, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kane inspektuar Objektivin dhe kane konstatuar qe nuk ka difekte dhe punime te pakryera si dhe qe ai funksionon ne perputhje me Projektin.
 - Per difektet qe nuk jane ndrequr gjate Afatit te Garancise se punimeve te ndertimit, AK llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlere e Garancise se punimeve qe eshte ne masen **5%** te vleres totale te Kontrates.
 - Çmimet e punimeve do te jene ato te fituara ne tender, sipas preventivit te paraqitur nga Sipermarresi.
 - Bashkia Fier mund te beje ne çdo kohe porosi tek Kontraktori per te bere ndryshime (specifikime teknike) brenda qellimit te pergjithshem te kontrates.




- 6 -



4. Te marre ne dorezim Objektin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
4. Me marrjen e Objektivit ne dorezim, te filloje menjehere punimet e ndertimit. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit (sheshit te ndertimit) ne dorezim.**
5. Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositet, afatet dhe rruget kritike per aktivitetet e Punimeve.
6. Te caktoj drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.
7. Te njohe, te respektoj termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijoj kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
8. Te realizoj Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundoj punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se **3 muaj**.
9. Te pranoj cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Investitori ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
10. Gjate kryerjes se punimeve, te njoftoj ne kohe dhe zyrtarisht Investitorin per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimin te Investitorit per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezulloje) punimet.
11. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyet e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.
12. Autoriteti Kontraktor, mund te jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
13. Te siguroj vete transportin, makinerite, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohej qe rolin e sipermarresit t'ia jape nje subjekti tjetër.**
14. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshem/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuara edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
15. Te njoftoj me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.
16. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
17. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materjaleve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
18. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjitha dokumentacionin shkresor te perditësuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

V. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim. Bashkia Fier ne baze te Kontrates se bashkpunimit dhe Prokures se Posacme te Bashkimit te Perkohshem te ketyre shoqerive njeh dhe mban kontakte me perfaqesuesin e autorizuar te ketij bashkimi, shoqerine **"Kola Invest" shpk Fier**.



- 5 -



17. Kontraktori është i detyruar që të njoftojë dhe të rakordojë përpara, në vazhdim dhe në perfundim të punimeve me KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a për zgjidhjen bashkarisht të problemeve të infrastruktures së tyre, që të jenë prezente me specialistet e tyre kur do të kryhen punime të cilat kanë të bëjnë me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesiperme. Afati i njoftimit për këto subjekte do të jetë 5 (pese) dite përpara kryerjes së punimeve.
18. Kjo Kontratë hartohet në 6 kopje, 1 për Kontraktorin dhe 5 për Bashkinë e Fier dhe pasi lexohet nga palet, nënshkruhet prej tyre me vullnet të lirë në Fier sot me datë 08/07/2015.

Adresa :

Bashkia e Fier, L. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"
Rr. "Jani Bakalli" Fier
Tel/Fax : 034 22 25 87 www.bashkiafier.gov.al

Adresa :

"Kola Invest" sh.p.k. Lagja Kryengritja, Rruga Aulona,
Komp. Apollon, pallati nr.7, Fier
"Kupa" sh.p.k.; Durres

Për dhe në emër të :
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER

Baftjar ZEQAJ
KRYETAR I BASHKISË



Për dhe në emër të :

KONTRAKTORI

Bashkimi i perkohshëm i shoqerive

"KOLA INVEST" shpk Fier &

"KUPA" shpk Durres

Jani KOLA

PËRFAQËSUES LIGJOR KOLA INVEST

Shkelqim KUPA

PËRFAQËSUES LIGJOR (KUPA sh.p.k.)

